



Të jetosh me pak para

Jeta në Zvicër është relativisht e shtrenjtë. Për këtë e vlen që artikujt të caktuar të blehen të përdorur. Kush nuk ka para të mjaftueshme mund të blejë lirë në shitore speciale.

Artikujt e përdorur

Në Zvicër ka shumë shtëpi me mall të përdorur (Brockenhäuser | Brocantes). Aty munden të blehen artikujt e përdorur shumë lirë. Në tregje speciale ofrojnë edhe personat privat gjëra të përdorura. Shembuj janë tregjet me gjëra të përdorura, treg teshash, treg gjërash për skijim etj. edhe portalet në internet janë për blerje dhe shitje për artikujt e përdorur shumë të pëlqyer.

Sporti / Kultura / Arsimimi

Me Kulturlegi- letërnjoftim (Kulturlegi | CarteCulture) kanë njerëzit me pak para, lirim për sport-,kultur- dhe në veprimtari arsimore. Për këtë letërnjoftim mund të bëhet kërkesa në Karitas. Karitasi informohet dhe vërteton, se ka njeriu të drejtë të ketë kulturlegi.

Tregu i Caritasit

Njerëzit me pak para munden të blejnë në shitoret e Caritasit, (Caritas Markt | Epicerie Caritas) gjëra ushqimore dhe produkte për nevoja ditore me një çmim shumë të ulët. Për këtë i nevojitet njeriut një kartë speciale e që kërkesa duhet të bëhet në Caritas. Karitasi informohet dhe e vërteton a ka njeriu të drejtë me e marr një kartë të till. Në kantonin e Bernit ka shitore në Bern, Biel dhe Thun.

Tavolinë Shtrohu

Organizata "Tavolinë Shtrohu" ofronë gjëra ushqimore falas për personat me pak para. Qendrat publike dhe private këshilluese sociale munden ta lëshojnë një kartë për tërheqjen e gjërave ushqimore në këtë organizatë. Kjo kartë mundëson edhe vizitën e parë në të gjitha tregjet - e Caritasit (Caritas Markt | Epicerie Caritas). Aty mundet njeriu edhe ta bëjë një kërkesë për posedimin e kartës personale për Tregun- Caritasit në mënyrë që mund të bëhen blerje të tjera.

Mbështetja shtetërore

Kush ka para jo të mjaftueshme për të jetuar, ka në shumë raste të drejtën për mbështetje nga shteti. Kështu mundet p.sh. të aplikohet për të pasur zbritje në shumën e sigurimeve shëndetësore apo bursat për arsimim. Në situata të caktura jetësore merr njeriu para nga sigurimet sociale apo ndihmë sociale.



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/parat-dhe-tatimi/te-jetosh-me-pak-para

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri
Parat dhe tatimi / Të jetosh me pak para